

VENDIM
Nr. 396, datë 3.5.2017

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI), TË PRONËS SË PALUAJTSHME SHTETËRORE, APARTAMENTET NR.15, NR.16, NR.17 DHE NR.18, TË NDODHURA NË GODINËN NR.57, NË BULEVARDIN “ZOGU I PARË”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik te Ministria e Arsimit dhe Sportit, për Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), të pronës së paluajtshme shtetërore, apartamentet nr. 15, nr. 16, nr. 17 dhe nr. 18, të ndodhura në godinën nr. 57, në bulevardin “Zogu i Parë”, Tiranë, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi.


2. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit i ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

PLANIMETRIA E KATIT TE KATERT
Shkalla 1:100




Shkalla I Sip. Ap. 3, 2 + 1 = 77.8 m²
Sip. Ap. 4, 1 + 1 = 59.6 m²
Sip. Kafaz Shkalle = 28.2 m²
Sip. Totale = 165.6 m²

Shkalla II Sip. Ap. 15, 3 + 1 = 99.8 m²
Sip. Ap. 16, 1 + 1 = 59.6 m²
Sip. Kafaz Shkalle = 28.2 m²
Sip. Totale = 187.6 m²

OBJEKTI	PALLATI 57/1,2	
TITULLI I PLETES	PP/ANIMETRIA E KATIT TE KATERT	
FOROSITES	DREJTORIA E SHERRIMIT DIPLOMATIK	
GRUPI I PUNES	Nr. LICENSES	FIRMA
SH.F.K. " GJEOPOTO "		
Top. Ormas TOMJA	TZ - 0303	
Inq. Peshumb AJMEYAJ	K - 00201	

PLANIMETRIA E KATIT TE PESTE

Shkalla 1 : 100



Shkalla I Sip. Ap. 5, 2+1 = 77.8 m²
Sip. Ap. 6, 1+1 = 59.6 m²
Sip. Kafaz Shkalle = 28.2 m²
Sip. Totale = 165.6 m²

Shkalla II Sip. Ap. 17, 3+1 = 99.8 m²
Sip. Ap. 18, 1+1 = 59.6 m²
Sip. Kafaz Shkalle = 28.2 m²
Sip. Totale = 187.6 m²

OBJEKTI	PALLATI 37 / 1,2	
TITULLI I FLETES	PLANIMETRIA E KATIT TE PESTE	
FOROSITES	DREJTORIA E SHERRIMIT DIPLOMATIK	
GRUPI I FUTES	Nr. LICENSES	FIRMA
SILP.A.C. " GJEOPOTO "		
Top. Osmas TOMJA	TZ - 0383	
Ing. Fehmi AHNETAJ	K - 8028/1	

